



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 17 Mars 2021

Nr: 156

VENDIM

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E LISTAVE SHUMEMËRORE TE KOALICIONIT “PARTIA DEMOKRATIKE - ALEANCA PËR NDRYSHIM (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)” PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN TË DATËS 25 PRILL 2021

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 68, 72, pikat 1 e 2, dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, dhe të shkronjës “a”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, pasi shqyrtova kërkesën e depozituar nga Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)” për regjistrimin e listave shumëmemërore për zgjedhjet për Kuvendin që do të zhvillohen në datën 25 Prill 2021,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92 shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin.

Me vendimin nr. 107, datë 2.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)” është regjistruar si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021.

Në bazë të nenit 67 dhe nenit 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-

Për miratimin e kërkesës për regjistrimin e listave shumëmemërore të Koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)” për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021

Data: 17 Mars 2021

Nr. 156



PKD-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)” ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumemërore më datë 8.3.2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 131 datë 10.3.2021, vendosi kthimin për korrigjim të dokumentacionit, të listës shumemërore të kandidatëve për deputetë të subjektit zgjedhor Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJPKD-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)”.

Brenda afatit ligjor, subjekti zgjedhor Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJPKD-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)” depozitoi dokumentacionin e korrigjuar.

Dokumentacioni i paraqitur përmban:

1. Listat shumemërore për 12 Zonat Zgjedhore; Model - 03
2. Deklaratat e kandidatëve të listave shumemërore, të cilët deklarojnë se gëzojnë të drejtën e votës dhe se pranojnë të kandidojnë si kandidat të listës shumemërore të Koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJPKD-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)”;
3. Kopje të dokumentit të identifikimit për të gjithë kandidatët e listave shumemërore;
4. Jetëshkrimin për të gjithë kandidatët e listës shumemërore Model – 07;
5. Listat mbështetëse me nënshkrimet e zgjedhësve, së bashku me kopje të dokumentit të identifikimit, të nënshkruar prej tyre; Model - 06;
6. Formularët e vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar.
7. Deklaratën Model 03/1 për disa kandidatë të cilët kanë planifikuar marrjen/ pranimit donacione.

Në mbështetje të nenit 68, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7 të udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, Komisioneri ftoi përfaqësuesin e subjektit zgjedhor të koalicionit PD-AN, për të qenë prezent në seancën publike.

Neni 68 pika 1 përcakton se në rastin e koalicionit zgjedhor listat në tërësi duhet të kenë marrë mbështetjen e jo më pak se 7,000 zgjedhësve në shkallë kombëtare.

Administrata e KQZ-së verifikoi nënshkrimet e zgjedhësve në listat mbështetëse për të cilat rezultoi se gjithsej janë dorëzuar 14750 (katërmëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë)



nënshkrime të plotësuara sipas modelit 06. Për çdo zgjedhës në listë bashkëlidhur është depozituar dhe kopje e letërnjoftimit e nënshkruar prej tyre.

Në bazë të nenit 71, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nga administrata e KQZ-së është bërë verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar duke përzgjedhur në mënyrë rastësore 5% të zgjedhësve nga lista e zgjedhësve mbështetës. Numri i zgjedhësve të verifikuar është 350 (treqind e pesëdhjetë).

Në përfundim, nga verifikimi i nënshkrimeve të depozituara nga zgjedhësit mbështetës rezulton se, numri i zgjedhësve që kanë nënshkruar në listën mbështetëse është më i madh se numri minimal i kërkuar në bazë të nenit 68, pika 1 të Kodit Zgjedhor, për nënshkrimet.

Në zbatim të nenit 73 të Kodit Zgjedhor, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listat shumëmemërore të kandidatëve për deputet të Koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)” dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur dhe konstatoi se listat shumëmemërore për zonat zgjedhore në vijim kanë më shumë kandidatë se numri i përcaktuar i kandidatëve për atë zonë zgjedhore, përkatësisht:

Zona Zgjedhore Qarku Elbasan ka 21 kandidatë nga 15 kandidatë që kërkohet sipas nenit 67, pika 4, të Kodit Zgjedhor, duke paraqitur 6 kandidatë më shumë.

Zona Zgjedhore qarku Dibër ka 9 kandidatë nga 6 kandidatë që kërkohet sipas nenit 67, pika 4, të Kodit Zgjedhor, duke paraqitur 3 kandidatë më shumë.

Zona Zgjedhore qarku Fier ka 24 kandidatë nga 18 kandidatë që kërkohet sipas nenit 67, pika 4, të Kodit Zgjedhor, duke paraqitur 6 kandidatë më shumë.

Zona Zgjedhore qarku Berat ka 12 kandidatë nga 9 kandidatë që kërkohet sipas nenit 67, pika 4, të Kodit Zgjedhor, duke paraqitur 3 kandidatë më shumë.

Zona zgjedhore qarku Durrës ka 21 kandidatë nga 15 kandidatë që kërkohet sipas nenit 67, pika 4, të Kodit Zgjedhor, duke paraqitur 6 kandidatë më shumë.

Zona zgjedhore, qarku Korçë ka 21 kandidatë nga 12 kandidatë që kërkohet sipas nenit 67, pika 4, të Kodit Zgjedhor duke paraqitur 9 kandidatë më shumë.

Zona zgjedhore, qarku Kukës ka 9 kandidatë nga 3 kandidatë që kërkohet sipas nenit 67, pika 4, të Kodit Zgjedhor duke paraqitur 6 kandidatë më shumë.

Zona zgjedhore qarku Lezhë ka 12 kandidatë nga 9 kandidatë që kërkohet sipas nenit 67, pika 4, të Kodit Zgjedhor duke paraqitur 3 kandidatë më shumë.

Zona zgjedhore, qarku Shkodër ka 21 kandidatë nga 12 kandidatë që kërkohet sipas nenit 67, pika 4, të Kodit Zgjedhor duke paraqitur 9 kandidatë më shumë.



Zona zgjedhore, qarku Tiranë ka 45 kandidatë nga 36 kandidatë që kërkohet sipas nenit 67, pika 4, të Kodit Zgjedhor, duke paraqitur 9 kandidatë më shumë.

Zona zgjedhore, qarku Vlorë ka 18 kandidatë nga 12 kandidatë që kërkohet sipas nenit 67, pika 4, të Kodit Zgjedhor, duke paraqitur 6 kandidatë më shumë.

Zona Zgjedhore qarku Gjirokastrë ka 9 kandidatë nga 6 kandidatë që kërkohet sipas nenit 67, pika 4, të Kodit Zgjedhor, duke paraqitur 3 kandidatë më shumë.

Përveç sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara nga neni 67 dhe neni 72 të Kodit Zgjedhor.

Në përputhje me nenin 5, pika 4, shkronja “a”, të ligjit, nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, kandidatët për deputet, të subjektit politik Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)”, kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit, të kandidatëve për deputetë, rezultojnë se përveç kandidatëve të poshtëpërmendur, të gjithë kandidatët e tjerë nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar.

1. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Xhelal Rrahman Mziu**, kandidat për deputet, qarku Dibër me numër rendor 1, rezultojnë se ka deklaruar :
Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,

Pikës 2, “A jeni dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

- Me vendimin nr. 1118 datë 10.04.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e ka dënuar për veprën penale “Shpërdorim detyre në bashkëpunim” parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal, për të cilën është vendosur masë dënimi 2 (dy) vite burg dhe 2 (dy) vite mos ushtrim i funksioneve publike.



- Me vendimin nr. 496 datë 22.04.2016, Gjykata e Apelit Tiranë, e ka dënuar për veprën penale “Shpërdorim detyre në bashkëpunim” parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal, për të cilën është vendosur prishje e vendimit nr. 1118 datë 10.04.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pushimin e çështjes në ngarkim të të pandehurit z. Xhelal Mziu.
- Me vendimin nr. 00-17-1014 datë 21.12.2017, Gjykata e Lartë, Kolegji Penal Tiranë, e ka dënuar për veprën penale “Shpërdorim detyre në bashkëpunim” parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal, për të cilën është vendosur mospranim i rekursit të paraqitur nga Prokuroria e Apelit, Tiranë.

Pikës 4, “A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se: Është ndaluar/arrestuar nga Prokuroria e Tiranës, për arsye dyshimi të kryerjes së veprës penale “Shpërdorim i detyrës në bashkëpunim”, më datë 20.12.2013-13.01.2014, për të cilën është vendosur masa e dënimit me burg.

Pikës 5, “A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo?” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

- Është caktuar masë e sigurisë detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore si dhe arrest me burg, masë e cila është revokuar, nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, për veprën penale “Shpërdorim detyre” parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal, më datë 20.12.2013-13.01.2014.
- Është caktuar masë e sigurisë detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore si dhe arrest me burg, masë e cila është revokuar, nga Gjykata e Apelit Tiranë, për veprën penale “Shpërdorim detyre” parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal, më datë 20.12.2013-13.01.2014.

Pikës 8, “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “PO”, duke deklaruar se:

- Ka jetuar në Greqi, për arsye emigracioni për periudhën korrik-gusht 1992.
- Ka jetuar në Greqi, për arsye emigracioni për periudhën shtator-dhjetor 1995.

Referuar deklaramete të kandidatit në formularin e vetëdeklarimit, nga verifikimi prima facie konstatohet se, vepra penale “Shpërdorim Detyre” përfshihet nën parashikimet e nenit 2 “Ndalimi për kandidim dhe për t’u zgjedhur në një funksion të lartë public”, shkronja “b”, të ligjit nr. 138/2015. Pavarësisht se vepra penale përfshihet në fushën e ndalimit të ligjit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk mund të shprehet në këtë moment, sepse nga dokumentacioni që disponon, vendimi gjyqësor nuk është i formës së prerë, ashtu sikundër ligji kërkon shprehimisht.

2. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Edi Tonin Paloka**, kandidat për deputet, qarku Durrës me numër rendor 1, rezulton se ka deklaruar :

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,

Pikës 1, “A keni jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

- Me vendimin nr. 8 datë 05.06.2015, Gjykata e Lartë, e ka dënuar për veprën penale “Shpifje”, parashikuar nga neni 120/2 i Kodit Penal.

- Me vendimin nr. 10 datë 12.01.2001, Gjykata e Rrethit Tiranë, e ka dënuar për veprën penale “Organizim i manifestimeve të paligjshme”, parashikuar nga neni 262/1 i Kodit Penal.

Pikës 4, “A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

- Është arrestuar në flagrancë nga Policia e Tiranës, për arsye të parashikuar nga nenet 262/1 dhe 236//2 Kodi Penal, më datë 29.11.2000.

Pikës 5, “A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo?” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

- Është caktuar masë e sigurisë arrest me burg, masë e cila është revokuar, nga Gjykata Shkallës së Parë Tiranë, për veprën penale “Miting i paligjshëm për kundërshtim me forcë të policisë”, më datë 30.01.2000, për të cilën është vendosur vendim përfundimtar arrest me burg për nja afat 10 (dhjetë) ditor.

Pikës 8, “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “PO”, duke deklaruar se:

- Ka jetuar në Itali, për arsye emigracioni për periudhën prill-nëntor 1991.

- Ka jetuar në Itali, për arsye emigracioni për periudhën nëntor 1991 deri më prill 1992.

Referuar të dhënave të deklaruara të kandidatit në formularin e vetëdeklarimit vërehet se vepra penale “Shpifje” sipas parashikimeve të nenit 120/2, i Kodit Penal, nuk përfshihet në fushën e ndalimeve të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015. Referuar të dhënave të disponuara, kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhshmërisë.

3. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Luçiano Dhimitër Boçi**, kandidat për deputet, qarku Elbasan me numër rendor 7, rezulton se ka deklaruar :



Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,

Pikës 2, “*A jeni dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë?*”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

- Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, e ka dënuar veprën penale të “Fyerjes dhe shpifjes ndaj Ministres së Arsimit” me vendim përfundimtar 70 (shtatëdhjetë) mijë lekë gjobë.

Pikës 4, “*A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?*”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

- Është arrestuar në Elbasan, për arsye të pjesëmarrjes dhe organizimit të protestës së paligjshme në shtator 2018.

Pikës 8, “*A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?*”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “PO”, duke deklaruar se:

- Ka jetuar në Francë, për arsye studimi për periudhën nëntor-dhjetor 1995.
- Ka jetuar në Itali, për arsye studimi për periudhën mars-prill 2001.

Referuar të dhënave të deklaruara të kandidatit në formularin e vetëdeklarimit konstatojmë se, vepra penale “Shpifje dhe fyerje ndaj Ministres së Arsimit” nuk përfshihet në fushën e ndalimeve të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015. Referuar të dhënave të disponuara, kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhshmërisë.

4. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Agron Fasli Kapllanaj**, kandidat për deputet, qarku Fier me numër rendor 7, rezulton se ka deklaruar :

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,

Pikës 1, “*A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?*”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

- Për ngjarjen e ndodhur më datë 26.07.1995, sipas nenit 624 c.d

Pikës 3, “*A keni qënë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale?*”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:



- Është hetuar/gjykuar nga Gjykata e Firenze, në Itali, për veprën penal e parashikuar sipas nenit 624 c.d.

Referuar të dhënave të deklaruara të kandidatit në formularin e vetëdeklarimit si dhe vendimit nr. 569 datë 03.11.2017 “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Agron Kapllanaj, kryetar i Bashkisë Mallakastër, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve konstatohet se, referuar fakteve dhe zbatimit të ligjit, z. Agron Fasli Kapllanaj, është dënuar me një vendim të formës së prerë me burg me 2 (dy) vite. Gjykata Italiane ka vendosur pezullimin me kusht të ekzekutimit të dënimit. Rezulton që vendimi ka marrë formë të prerë në datë, 17.02.2004. Referuar nenit 4, pika 3 të ligjit 138/2015, periudha e ndalimit është 10 vite.

Periudha dhjetë vjecare e ndalimit fillon saktësisht 1 (një) ditë pasi vendimi i dënimit të merrte formë të prerë, pra në datë 18.02.2004. Kjo sepse momenti i përfundimit të dënimit me burg është pikërisht momenti kur gjykata ka vendosur që ky dënim duhet pezulluar. Pra, duke qënë se vendimi ka marrë formë të prerë më datë 17.02.2004 dhe periudha e ndalimit të dënimit është 10 vite, rezulton që më datë 18.02.2014 ka përfunduar periudha e ndalimit. Me përfundimin e periudhës së ndalimit për të kandiduar apo për ushtrimin e funksionit, në kuptim të ligjit nr.138/2015 subjekti konsiderohet i rehabilituar.

Në këto kushte konstatohet se, z. Agron Fasli Kapllanaj, nuk përfshihet në sferën e ndalimeve të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015. Referuar të dhënave të disponuara kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhshmërisë.

5. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **zj. Manjola Kastriot Nikollo**, kandidat për deputet, qarku Vlorë me numër rendor 15, rezulton se ka deklaruar :

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,

Pikës 1, “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

- Me vendimin nr. 23-2016-2116 (323) datë 14.11.2016, është dënuar me shërbim prove.

Referuar të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit konstatohet se vepra penale për të cilën z. Manjola Kastriot Nikollo është dënuar me shërbim prove, nuk përfshihet në sferën e ndalimeve të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015. Për sa më sipër, kandidati ka dhënë informacion jo të qartë, por nga vlerësimi prima facie i dënimit, kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhshmërisë, në momentin e miratimit të listës shumecëmërore.

6. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Gentian Fiqiri Muça**, kandidat për deputet, qarku Tiranë me numër rendor 26, rezulton se ka deklaruar :



Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,

Pikës 7, “A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj?” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

- Është marrë masë dëbimi në Gjermani për shkak të shkeljes së vizës studentore më datë 17.01.2008, vendim i zyrës së emigracionit, Bashkia Koln, Bonn.
- Është ndaluar në aeroportin Budapest , për expuls për llogari të shtetit Gjerman, më korrik 2011, në autoritetin kufitar, Budapest.

Referuar të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit, konstatohet se kandidati nuk përfshihet në sferën e ndalimeve të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015. Referuar të dhënave të disponuara kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhshmërisë në momentin e miratimit të listës shumecëmërore.

7. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Rezart Xhelal Tusha**, kandidat për deputet, qarku Durrës me numër rendor 8, rezulton se ka deklaruar :

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,

Pikës 7, “A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj?” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

- Është marrë masë dëbimi në Zvicër për shkak të tejkalim të lejes së qëndrimit, në vitin 1994-1995, duke deklaruar se nuk disponon akt të dëbimit. Deklaron se e ndalojnë dhe i komunikojnë që i ka mbaruar leja e qëndrimit provizore dhe duhet të largohet nga Zvicra (komunikim verbal). Pas disa vitesh deklaroi se ka hyrë dhe herë të tjera në Zvicër pa asnjë problem.

Referuar të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit konstatohet se kandidati nuk përfshihet në sferën e ndalimeve të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015. Referuar të dhënave të disponuara kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhshmërisë në momentin e miratimit të listës shumecëmërore.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit, nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, paragrafi 2, shkronja “b” dhe paragrafi 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, me shkresën nr. 2190 prot.,



datë 17.03.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatët për deputet në Kuvendin e Shqipërisë, të Koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJPKD-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)”, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ende nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës sonë në lidhje me verifikimin e të dhënave të kandidatëve për deputetë të Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJPKD-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)”.

Referuar ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit për kandidatët për deputet, të Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim(PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJPKD-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)”,nuk përfshihen në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit nr. 138.2015.

Në lidhje me numrin e kandidatëve për deputetë në listat shumëmemërore të Koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim(PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJPKD-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se:

Neni 67 pika 4 e Kodit Zgjedhor përcakton se “Numri i kandidatëve në listën shumëmemërore nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse, shtuar dy. Në çdo rast, numri i kandidatëve në listën shumëmemërore duhet të jetë i plotpjesëtueshëm me numrin tre”.

Në përputhje me parashikimet e nenit 64 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kuvendi përbëhet nga 140 deputet (mandate).

Komisioni Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, me vendimin nr.7, datë 11 dhjetor 2020 ka përcatuar numrin e mandateve për cdo zonë zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021, si vijon: Berat 7, Dibër 5, Durrës 14, Elbasan 14, Gjirokastrë 4, Fier 16, Korçë 11, Kukës 3, Lezhë 7, Shkodër 11, Tiranë 36, Vlorë 12, në total 140 deputetë.

Sa parashikon neni 67 pika 4 e Kodit Zgjedhor më sipër cituar, është një përcaktim që nuk tregon numrin minimal të kandidatëve në listën shumëmemërore, por tregon sesa është ky numër. Në kuptim të përmbajtjes së kësaj pike të Kodit Zgjedhor, ky numër i kandidatëve në listën shumëmemërore përcaktohet nga tre elementë apo tre kritere:

- 1- Numrin e mandateve në zonën zgjedhore
- 2- Numrin 2 (dy), (pra shtuar 2 (dy));



3- Plotëpjesëtimin me numrin 3 (për respektimin e kuotës gjinore)

Pra, rregullat që burojnë nga parashikimi i nenit 67, pika 4 e Kodit Zgjedhor janë si më poshtë:

- 1- Është detyrim për partitë politike që numri i kandidatëve në listën shumemërore nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në atë zonë. Pra, duke marrë si shembull rastin e Dibrës (5 mandate me vendimin e KRR) theksojmë se partitë politike nuk mund të sjellin listë me 4 emra, pra me një numër më të vogël se numri i mandateve për atë zonë zgjedhore.

Shprehja “shtuar dy” lë vend për interpretim. Interpretimi lind pasi togfjalëshi “**në çdo rast**” që fillon fjalia vijuese, lë të kuptohet se situata e parashikuar në rregullin e parashikuar nga fjalia e parë nuk mund të jetë vetëm një (pra, numri i mandateve në zonë, plus dy), por lë të kuptohet se mund të ketë më shumë se 1 (një) që mund të jetë ose jo i plotëpjesëtueshëm me numrin 3 (tre). Marrim sërish rastin e Dibrës me 5 mandate. Në rast se do ta interpretonim nenin 67, pika 4, vetëm me një rast parashikimi (pra numrin e mandateve në zonë plus 2 (dy)) atëherë në rastin e Dibrës do të gjendeshim në situatën që numrit 5 t’i shtonim 2, d.m.th, $5+2=7$ kandidatë në listat shumemërore. Edhe numri 5 edhe numri 7 nuk janë të plotëpjesëtueshëm me numrin 3 (tre). Pra, në këtë mënyrë interpretimi të nenit, është e pamundur të respektonim parashikimin ligjor.

Kjo situatë vihet re edhe në zonat zgjedhore Durrës ($14+2=16$), Elbasan ($14+2=16$), Korçë ($11+2=13$), Kukës ($3+2=5$), Shkodër ($11+2=13$), Tiranë ($36+2=38$) dhe Vlorë ($12+2=14$). Të gjithë rastet nuk janë të plotëpjesëtueshëm me numrin 3 (tre). Në këtë mënyrë të interpretuari, formula nuk është funksionale.

- 2- Për të kapërcyer situata të tilla, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se, rregulli vijues pas rregullit në pikën 1, për zbatimin e nenit 67, pika 4, duhet të jetë i tillë që, në rastet kur numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore, të përcaktuar me vendimin e KRR cituar më sipër, është i plotëpjesëtueshëm me numrin tre (3), atëherë nuk është e nevojshme shtesa në numrin e kandidatëve në listat shumemërore.

- 3- Në rastet kur numri i mandateve për zonën zgjedhore nuk është i plotëpjesëtueshëm me numrin 3 (tre) i shtohet 1 (një) për ta bërë të plotëpjesëtueshëm me numrin tre (3) dhe në rast se sërish shuma është jo e plotëpjesëtueshme me numrin 3, atëherë i shtojmë 2.

Në këtë mënyrë, respektohet edhe limiti prej 2 mandatesh shtesë që ka parashikuar dispozita dhe në të njëjtën kohë bëhet e zbatueshme.

Është e qartë se dispozita në fjalë (neni 67, pika 4 i Kodit Zgjedhor) përcakton numrin e kandidatëve për deputetë në listat shumemërore të paraqitura në KQZ. Dispozita përcakton ekzaktësisht sa do të jetë numri i kandidatëve për deputetë dhe nuk përcakton numrin minimal, sepse përndryshe do të duhej që



ligjvënësi të kishte përcaktuar edhe se sa do të ishte numri maksimal ose do të duhej t'ia kishte lënë këtë kompetencë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Por kjo dispozitë mungon. Sa më sipër është një argument logjik për të theksuar edhe njëherë se është pikërisht parashikimi i nenit 67, pika 4 që përcakton numrin e kandidatëve për deputetë në listat shumëmemërore të subjekteve zgjedhore.

Ratio (themeli i një zgjedhje ligjore) e normës juridike është të vendosë kufirin e sipërm të listës, pasi kufiri i poshtëm është sa numri i mandateve. Kufiri i sipërm i listës së kandidatëve është numri më i afërt i plotpjesëtueshëm me 3 i numrit të mandateve, deri 2. Infiniti nuk është ratio i normës.

Më tej, vlerësoj se, ndonëse numri i kandidatëve i listës shumëmemërore nuk është në përputhje me përcaktimet e Kodit Zgjedhor, nuk jemi në kushtet ligjore të refuzimit të listës të parashikuara në nenin 67 pika 7 e Kodit Zgjedhor ku parashikohet se: “Në rast mospërmbushjeje të njërit prej kushteve të parashikuara në këtë nen, në lidhje me përbërjen e listës shumëmemërore KQZ-ja zbaton sanksionet e parashikuara në nenin 175 të Kodit Zgjedhor”. Neni 175 i Kodit Zgjedhor parashikon sanksionin për mosrespektim të barazisë gjinore si vijon: “mospërmbushja nga subjekti zgjedhor i detyrimit të parashikuar në pikën 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor passjell refuzimin e listës shumëmemërore për t’u regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”.

Do të ishim përpara shkaqeve për refuzimin e listës nëse nuk do të ishte respektuar kuota gjinore. Dhe ky nuk është rasti, pasi subjekti zgjedhor e ka respektuar kuotën gjinore. Do të përbënte shkak për refuzim të listës nëse nuk do të kishim një listë kandidatësh për çdo qark, gjë që ky koalicion e ka respektuar, ne kemi listën për çdo qark, dhe nëse numri i kandidatëve nuk do të ishte aq sa kërkon Kodi Zgjedhor. Në rastin konkret kemi një numër më të madh kandidatësh sesa kërkon Kodi Zgjedhor, kështu që, në këto rrethana vlerësoj se nuk jemi në kushtet ligjore për të refuzuar listën.

Për sa më lart, listat shumëmemërore të Koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)”, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill, do të jenë si vijon: për zonat Zgjedhore Qarku Berat për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 9, Qarku Dibër për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 6, Qarku Durrës për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 15, Qarku Elbasan për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 15, Qarku Fier për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 18, Qarku Gjirokastrë për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 6, Qarku Korçë për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 12, Qarku Kukës për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në 3, Qarku Lezhë për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 9, Qarku Shkodër për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 12, Qarku Tiranë për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në 36 dhe Qarku Vlorë për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 12.



PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 68, 72, pikat 1 e 2 dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, dhe në shkronjën “a”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar,

V E N D O S :

1. Miratimin e listave shumëmemërore të Koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)”, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi për zonat Zgjedhore Qarku Berat për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 9, Qarku Dibër për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 6, Qarku Durrës për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 15, Qarku Elbasan për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 15, Qarku Fier për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 18, Qarku Gjirokastër për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 6, Qarku Korçë për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 12, Qarku Kukës për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në 3, Qarku Lezhë për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 9, Qarku Shkodër për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 12, Qarku Tiranë për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në 36 dhe Qarku Vlorë për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 12.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





Lista shumemërore

Koalicioni Partia Demokratike "Aleanca për Ndryshim"
Qarku Berat

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Partia
1	Tomor	Fejzi	Alizoti	06/12/1976	M	PD
2	Kasëm	Bajram	Mahmutaj	16/04/1962	M	PD
3	Aferdita	Stiliano	(Pushi)Gjini	05/05/1966	F	PD
4	Bujar	Nuri	Hoxhaj	28/10/1966	M	PD
5	Pellumb	Meston	Nako	18/01/1960	M	PD
6	Alketa	Byniamin	Mukavelati	23/02/1975	F	PD
7	Ardit	Qamil	Benja	12/08/1990	M	PD
8	Denis	Pavlo	Saatçiu	26/04/1985	M	PD
9	Ermira	Markush	Arizi(Bullari)	20/04/1971	F	PD

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 9Koalicioni Partia Demokratike "Aleanca për Ndryshim"
Qarku Dibër

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Partia
1	Xhelal	Rrahman	Mziu	14/04/1967	M	PD
2	Kreshnik	Shaban	Çollaku	07/09/1970	M	PD
3	Dhurata	Bajram	Tyli (Çupi)	21/04/1973	F	PD
4	Edmond	Xheladin	Isaku	08/05/1964	M	PD
5	Luan	Qamil	Haka	02/09/1973	M	PD
6	Irini	Arif	Shehu	17/01/1981	F	PLL

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 6



Lista shumemërore

Koalicioni Partia Demokratike "Aleanca për Ndryshim"
Qarku Durrës

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Partia
1	Edi	Antonin	Paloka	23/12/1965	M	PD
2	Agron	Enver	Duka	22/01/1958	M	P.A.A
3	Merita	Gezim	Bakui	24/01/1972	F	PD
4	Oerd	Eqrem	Bylykbashi	23/05/1974	M	PD
5	Ferdinant	Mynyr	Xhaferaj	23/01/1964	M	PD
6	Andia	Sulejman	Ulliri	01/02/1999	F	PLL
7	Igli	Latif	Cara	16/03/1969	M	PD
8	Rezeart	Xhelal	Tusha	01/05/1972	M	PD
9	Manjola	Ramiz	Luku	25/12/1977	F	PD
10	Florian	Kujtim	Tahiri	23/02/1986	M	PDIU
11	Agim	Nazif	Baçi	14/09/1971	M	PD
12	Blerina	Niazi	Reçi	07/05/1974	F	PD
13	Selman	Mustafa	Tema	01/09/1968	M	PD
14	Erzen	Agim	Laçi	21/08/1988	M	PD
15	Merita	Shefki	Dakovelli	20/09/1968	F	PD

Kjo listë mbyllet me numrin rendor **15**Koalicioni Partia Demokratike "Aleanca për Ndryshim"
Qarku Elbasan

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Partia
1	Gazment	Durim	Bardhi	06/07/1986	M	PD
2	Flutura	Abdurrahman	Açka	04/06/1966	F	PD
3	Lefter	Lush	Gështenja	07/04/1972	M	PD
4	Dashnor	Riza	Sula	12/03/1969	M	PD
5	Eugen	Skender	Isaj	01/10/1972	M	PD
6	Zheni	Stefan	Gjergji	04/07/1971	F	PD
7	Luçiano	Dhimitër	Boçi	26/03/1967	M	PD
8	Qani	Rexhep	Xhafa	11/10/1969	M	PR
9	Lumturi	Mehmet	Hasa	04/01/1977	F	PDIU
10	Durim	Ali	Çekrezi	09/04/1967	M	PD
11	Fadil	Petref	Merzheku	17/10/1964	M	PD
12	Gladiola	Ismail	Çala	10/03/1986	F	LZHK
13	Anila	Hysen	Bishqemi	09/02/1981	F	PD
14	Ardian	Xhevahir	Zeneli	22/01/1970	M	PD
15	Mehdi	Jakup	Shehu	12/04/1960	M	PD

Kjo listë mbyllet me numrin rendor **15**



Lista shumemërore

Koalicioni Partia Demokratike "Aleanca për Ndryshim"
Qarku Fier

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Partia
1	Enkelejd	Lutfi	Alibeaj	11/09/1973	M	PD
2	Eralda	Jani	Bano(Tase)	24/05/1975	F	PR
3	Saimir	Sadik	Korreshi	13/03/1981	M	PD
4	Luan	Ramadan	Baçi	12/07/1963	M	PD
5	Nustret	Sulejman	Avdulla	18/10/1962	M	PDIU
6	Ilda	Thoma	Dhori	18/05/1990	F	PD
7	Agron	Faslli	Kapllanaj	15/09/1968	M	PD
8	Eduart	Shyqyri	Sharka	09/01/1968	M	P.A.A
9	Luljeta	Kadri	Sejko	29/09/1965	F	PD
10	Ferdinant	Nazmi	Çobo	06/11/1968	M	PR
11	Shpëtim	Avni	Axhani	02/09/1968	M	PLL
12	Alketa	Nëntor	Lugaj	24/07/1973	F	PD
13	Ledio	Tahir	Kastrati	10/02/1984	M	PD
14	Dilaver	Idai	Kamberaj	31/03/1970	M	PD
15	Silva	Bujar	Hasaj	22/08/1992	F	FRD
16	Edmond	Vezir	Çepele	21/09/1989	M	PD
17	Elizabeta	Agim	Rredhi	22/09/1990	F	PD
18	Jakup	Aqif	Beqiri	01/01/1962	M	PD

Kjo listë mbyllet me numrin rendor **18**Koalicioni Partia Demokratike "Aleanca për Ndryshim"
Qarku Gjirokastrë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Partia
1	Tritan	Masar	Shehu	24/04/1949	M	PD
2	Roland	Hysen	Bejko	07/02/1969	M	PD
3	Entela	Ali	Shehaj	12/08/1970	F	PD
4	Koço	Spiro	Barka	30/03/1954	M	PD
5	Myzafer	Servet	Elezi	20/05/1970	M	PD
6	Joana	Spiro	Qirollari	01/01/1976	F	PD

Kjo listë mbyllet me numrin rendor **6**



Lista shumemërore

Koalicioni Partia Demokratike "Aleanca për Ndryshim"
Qarku Korçë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Partia
1	Edmond	Shyqyri	Spaho	14/11/1958	M	PD
2	Sorina	Vangjush	Koti	03/08/1984	F	PD
3	Ervin	Bujar	Salianji	16/01/1988	M	PD
4	Bledjon	Tomor	Nallbati	08/07/1985	M	PD
5	Seladin	Fuat	Jakupllari	24/02/1967	M	PD
6	Marjeta	Bardhyl	Halili	21/02/1971	F	PD
7	Andrea	Nesti	Mano	06/07/1971	M	PD
8	Alfred	Perparim	Gega	29/03/1971	M	PD
9	Soela	Arjan	Myrtollari	15/01/1990	F	PD
10	Erion	Skender	Haruni	25/07/1978	M	PR
11	Andrea	Kostandin	Simaku	06/09/1964	M	PBDNJ
12	Anila	Namik	Hysenbegasi	17/05/1974	F	PD

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 12Koalicioni Partia Demokratike "Aleanca për Ndryshim"
Qarku Kukës

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Partia
1	Flamur	Lutfi	Hoxha	20/03/1968	M	PD
2	Isuf	Zenel	Çelaj	13/11/1964	M	PD
3	Shyrete	Sadik	Koka	16/10/1975	F	PD

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 3Koalicioni Partia Demokratike "Aleanca për Ndryshim"
Qarku Lezhë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Partia
1	Mark	Pjetër	Marku	25/06/1966	M	PD
2	Agron	Nikolle	Gjekmarkaj	21/05/1974	M	PD
3	Lindita	Ilir	Metaliaj	22/09/1977	F	PR
4	Kastriot	Pren	Piroli	13/01/1971	M	PD
5	Zef	Gjergj	Gjoka	15/12/1961	M	PD
6	Roza	Luigj	Hilaj	25/11/1967	F	PD
7	Gjovalin	Kol	Laska	06/10/1975	M	PD
8	Salvador	Pretash	Kaçaj	23/10/1967	M	PD
9	Elda	Artan	Hoti	29/09/1992	F	PR

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 9



Lista shumemërore

Koalicioni Partia Demokratike "Aleanca për Ndryshim"
Qarku Shkodër

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Partia
1	Helidon	Skender	Bushati	08/04/1973	M	PD
2	Emilja	Pjerin	Koliqi	24/09/1963	F	PD
3	Ramadan	Rexhep	Likaj	10/01/1966	M	PD
4	Greta	Zef	Bardeli	12/04/1980	F	PD
5	Zef	Kin	Hila	23/02/1961	M	PD
6	Lodovik	Stak	Hasani	23/09/1967	M	PR
7	Bardh	Ali	Spahia	29/01/1976	M	PD
8	Nard	Lazer	Ndoka	18/05/1963	M	PD
9	Izmira	Niazi	Rusi(Ulqinaku)	24/04/1991	F	PD
10	Aldo	Rrok	Gega	04/06/1994	M	PD
11	Arben	Zef	Gjuraj	28/03/1969	M	PD
12	Helga	Ferdinand	Sallaku	18/05/1984	F	PD

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 12



Lista shumemërore

Koalicioni Partia Demokratike "Aleanca për Ndryshim"
Qarku Tiranë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Partia
1	Lulzim	Xhelal	Basha	12/06/1974	M	PD
2	Jorida	Hasan	Tabaku	01/07/1979	F	PD
3	Alfred	Gjovalin	Rushaj	19/05/1974	M	PD
4	Albana	Sadik	Vokshi	24/02/1971	F	PD
5	Sali	Ram	Berisha	15/10/1944	M	PD
6	Agron	Siri	Shehaj	08/12/1977	M	PD
7	Fatmir	Ali	Mediu	21/01/1967	M	PR
8	Grida	Agim	Duma	11/06/1977	F	PD
9	Shpëtim	Hysni	Idrizi	07/07/1967	M	PDIU
10	Belind	Zamir	Këlliçi	25/01/1987	M	PD
11	Vangjel	Jorgji	Dule	18/11/1968	M	PBDNJ
12	Mesila	Fatmir	Doda	16/02/1971	F	PD
13	Dashamir	Hamid	Shehi	28/10/1957	M	LZHK
14	Flamur	Dalif	Noka	03/03/1971	M	PD
15	Orjola	Hysni	Pampuri	13/11/1981	F	PD
16	Aldo	Tonin	Bumçi	11/06/1974	M	PD
17	Ivi	Spiro	Kaso	11/03/1979	M	PD
18	Orjela	Luftar	Nebijaj	21/07/1986	F	PD
19	Gent	Hysen	Strazimiri	06/10/1972	M	PD
20	Mirela	Fatmir	Dragoni(Tabaku)	31/12/1966	F	PD
21	Çlirim	Rustem	Gjata	03/02/1968	M	PD
22	Sali	Selim	Shehu	10/12/1962	M	FRD
23	Dorjan	Xhezair	Teliti	15/05/1981	M	PD
24	Enkelejda	Bujar	Sallaku	17/07/1967	F	PD
25	Arben	Zyhdi	Tafaj	06/07/1960	M	PD
26	Gentjan	Fiqiri	Muça	13/05/1987	M	PD
27	Arjana	Perparim	Çela	21/03/1976	F	PD
28	Artur	Daut	Roshi	12/06/1969	M	PD
29	Anduena	Qemal	Qefalia	05/02/1979	F	PD
30	Ylber	Shefki	Valteri	25/12/1961	M	PBD
31	Taulanda	Ali	Jupi	23/06/1973	F	PD
32	Petrit	Dine	Doda	01/03/1961	M	PLL
33	Korab	Qamil	Lita	09/02/1975	M	BLD
34	Lediana	Hajredin	Fratari	19/02/1989	F	PD
35	Asllan	Shaban	Dogjani	15/11/1967	M	PD



Lista shumemërore

Koalicioni Partia Demokratike "Aleanca për Ndryshim"
Qarku Tiranë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Partia
36	Et'hem	Zyber	Aga	26/02/1967	M	PD

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 36Koalicioni Partia Demokratike "Aleanca për Ndryshim"
Qarku Vlorë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Partia
1	Bujar	Farudin	Leskaj	03/07/1966	M	PD
2	Ina	Kadri	Zhupa	20/06/1987	F	PD
3	Fation	Sulo	Veizaj	18/09/1966	M	PD
4	Arbi	Dashamir	Agalliu	01/08/1984	M	PD
5	Gëzim	Nuri	Ademaj	24/11/1966	M	PDIU
6	Nada	Spiro	Daulija	10/03/1990	F	PD
7	Jolio	Kastriot	Dine	26/10/1992	M	PD
8	Julian	Hetem	Zoto	26/12/1975	M	PD
9	Nadire	Fevri	Meçorapaj	06/01/1981	F	PD
10	Vangjel	Thoma	Anagnosti	05/11/1954	M	PBDNJ
11	Atird	Nuri	Hoxha	13/12/1984	M	PD
12	Alta	Abdul	Haluci	20/04/1974	F	PD

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 12Subjekti Zgjedhor ka: 153 kandidatë